



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHETIT**

NJOFTIM

Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të infermierit ju bëjmë me dije sa më poshtë:

- Provimi i shtetit për profesionin e rregulluar të infermierit do të zhvillohet brenda periudhës kohore nga java e parë deri në javën e tretë të muajit Korrik 2018.

Provimi i shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë: Rruga: "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë.

Ditën e provimit kandidati duhet të jetë i pajisur me:

- letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal);
- kopje të Kartë ID ose Pasaportë;
- faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA në një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA sipas herës së pjesëmarrjes);

Kandidati duhet të paraqitet në QSHA **30 min. para fillimit** të provimit të shtetit, duke pasur parasysh rregullat e mëposhtme:

1. ndalohet **marrja me vete** dhe **përdorimi i celularëve** dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi;
2. ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;
3. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.

Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të infermierit, ju bëjmë me dije se:

- Tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit.
- Kandidatët lutemi të paraqiten **VETËM** në orarin e përcaktuar dhe publikuar në faqen web të QSHA.

Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni **emrin, atësinë, mbiemrin**, si dhe **datën** dhe **orën** e provimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën www.qsha.gov.al, rubrika lista e kandidatëve.

Në rast pasaktësie në të dhënat e paraqitura në web, lutemi të kontaktoni në adresën provimeshteti@outlook.com si dhe të njoftoni përpara se të hyni në ambientin e provimit.

SQARIM:

Ligji “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” në nenin 7 thekson sa më poshtë:

Personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.